



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

**STRATEGJIA
E ZHVILLIMIT TË
UNIVERSITETIT
"EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
PËR PERIUDHËN
2020 - 2025**

PËRMBAJTA

- HYRJA
- VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM DHE KUSHTET AKTUALE NË UNIVERSITETIN E GJIROKASTRËS
- MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE
- RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE EKZISTUESE TË STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TË REJA
- PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË UNIVERSITETIT “E. ÇABEJ”
- REKRUTIMI I STAFIT TË RI AKADEMIK
- MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT
- KËRKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE
- LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBËTARE
- ROLI NDËRKOMBËTAR
- FINANCAT DHE BURIMET FINANCIARE
- KËRKESAT FINANCIARE TË STRATEGJISË
- QEVERISJA BASHKËKOHORE
- MBI SITUACIONIN NË UGJ

HYRJE

Në vendin tonë ka disa vite, që ka filluar procesi i transformimit të arsimit sipas modeleve të sotme më të përparuara. Zhvillimi dhe institucionalizimi i politikave arsimore, modelet bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies garantojnë edhe suksesin e këtij procesi. Këto masa për transformimin e sistemit arsimor kanë synuar ristrukturimin dhe modernizimin edhe të Arsimit të Lartë.

Në këtë kuadër edhe Universiteti “Eqrem Çabej” ka bërë përpjekje për t’ju bashkëngjitur këtyre zhvillimeve, duke qenë i hapur kundrejtë ideve të reja bashkëkohore, hartimit dhe zbatimit të programeve të përparuara për zhvillimin e shoqërisë, duke nxitur ambiciet profesionale dhe angazhimet e mirefillta pedagogjike e shkencore.

Përfshirja në procesin e Bolonjes ka bërë që Universiteti i Gjirokastrës të reflektojë e përsosi ndryshime në strukture dhe përmbajtje. Stafit akademik po behet gjithnjë e më i kualifikuar dhe është rritur ndjeshëm bashkëpunimi i universitetit me universitetet partnere brenda e jashtë vendit. Megjithatë ndonjëherë në politikën arsimore të Arsimit të Lartë nuk janë marrë në konsideratë ndryshimet e faktoreve të mjedisit si kërkesat e tregut, influencat e politikave rajonale, kufizimet ligjore etj.

Transformimi i shoqërisë po shoqërohet me ndryshime të shpejta dhe me një shpërthim të vrullshëm të informacionit. Problemet e sotme nuk mund të zgjidhen me mendësitë e mëparshme. Shoqëria ka nevojë për qytetare që të mendojnë ndryshe nga vite më parë, të jenë krijues, të mendojnë në mënyrë kritike, të jenë në gjendje të zgjidhin probleme sado të nderlikuara të jenë ato dhe së fundi të jenë të pajisur me shprehje për të menaxhuar ndryshimet.

Hartimi, menaxhimi dhe zbatimi i këtij Plani – Strategjik i Zhvillimit të Universitetit do të jetë kyç i zhvillimit të suksesshëm të universitetit tonë dhe do të ndihmojë për një integrim me të mirë të universitetit me shoqërinë dhe rajonin në vitet në vijim.. Programi afatgjatë/mesëm për zhvillimin e Universitetit “E.Çabej” është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë në Evropë dhe në botë, dhe në veçanti me procesin e Bolonjes. Ky program afatgjatë/mesëm për zhvillimin e universitetit tonë do të jetë në sinkron me Strategjinë Kombëtare për Arsimin e Lartë, në lidhje me politikën afatmesme dhe afatgjatë në veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e stafit akademik dhe të grupeve studentore të interesuara për zhvillimin e këtij universiteti.

VESHTRIM I PERGJITHSHEM DHE KUSHTET AKTUALE NE UNIVERSITETIN E GJIROKASTRES

Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës është krijuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 414, date 12.11.1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik që ishte çelur qysh me 1971. Ai është institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor i Rajonit Jugor të Shqipërisë. Arsimi i lartë në Gjirokastrë, deri sa u kalua në themelimin e Universitetit ka patur një traditë dhe përvojë të konsiderueshme. Me 1968 hapet Filiali i Fakultetit Ekonomik (pa shkeputje nga puna) të Universitetit të Tiranës, i cili vazhdoi për 11 vjet. Një vit më vonë (1969) hapet dhe dega e Agronomisë, si Filial i Institutit të Lartë Bujqësor, e cila zgjati 10 vjet. Po në këtë vit u hap gjithashtu Instituti Pedagogjik 2-vjeçar pa shkeputje nga puna për përgatitjen e mësuesve për specialitete të tilla si: Gjuhë-Letërsi, Histori – Gjeografi, Biologji-Kimi dhe Matematikë-Fizikë. Gjithashtu u hap dhe funksionoi për 5 vjet, Filiali i Institutit të Kulturës Fizikë “Vojo Kushi”.

Mbi bazën e kësaj përvojë në vitin 1971, me Vendim të Keshillit të Ministrave, fillon veprimtarinë e tij Instituti i Lartë Pedagogjik 3-vjeçar me shkeputje nga puna, në fillim me degët Histori – Gjeografi dhe Matematikë – Fizikë. Në vitin 1980 hapet edhe dega e Biologji – Kimisë.

Në vitin 1981 Instituti i Lartë 3-vjeçar me Vendim të Keshillit të Ministrave, shndërrohet në Institut të Lartë Pedagogjik 4-vjeçar. Në këtë vit çëlet edhe dega e përgatitjes së mësuesve për shkollën fillore (Cikli i Ulet) dhe me Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 255, date 24.07.1986 u hap edhe dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Për një periudhë prej 10 vjetësh Instituti i Lartë Pedagogjik 4-vjeçar u kompletua me të gjitha profilet e përgatitjes së mësuesve, u konsolidua e u pasuria me bazën e nevojshme materiale-mesimore. U ndertua korpusi i ri me të gjitha mjediset e nevojshme për mesim si dhe godina e konviktit. Nga viti në vit u rrit shkalla e kualifikimit shkencor e pedagogjik të personelit akademik.

Në vitin akademik 1993-1994, me Vendim të Keshillit të Ministrave perkatesisht nr.435, date 03.09.1993 dhe nr. 300, date 21.06.1994 Universiteti i Gjirokastrës u zgjerua edhe me hapjen e dy degëve të reja, perkatesisht të degës së Gjuhës e Letërsisë Greke, e cila përgatit mësues për shkollat e minoritetit grek dhe asaj të Gjuhës e Letërsisë Angleze. Në vitin akademik 1996-1997 hapet dega Kontabilitet – Finance si dhe dega e Arsimit Parashkollor. Me Vendim të Keshillit të Ministrave nr.179, date 29.09.1998 kursi i studimit të degës Cikli i Ulet u bë nga 3-vjeçar në 4-vjeçar.

Në vitin 1998 hapet kursi i degës Infermieri e Lartë dhe në qershor të vitit 2001 u çel edhe dega e Administrimit Publik. Në vitin 2003 hapet dega Gjuhë – Letërsi Italiane, në vitin 2004 hapet dega Matematikë – Informatikë dhe në vitin 2005 hapet dega e Turizmit.

Në përgjithësi kontigjenti i studentëve në rrjedhën e dekadave ka ardhur nga gjithë rajonet e vendit dhe pjesërisht edhe nga trojet shqiptare jashtë kufijve si Kosova, Maqedonia dhe Greqia si dhe nga komuniteti rome etj.

Pas viteve 90-të harta e prurjeve studentore ka qënë dhe mbetet më e larmishme, e dominuar nga rajoni jugor dhe i Shqipërisë së mesme, por nuk kanë munguar prurjet edhe nga rrethet veriore e verilindore si Kukës, Tropojë, Mat, Dibër etj.

Ne vitin 1994 e në vazhdim, Universiteti “Eqrem Çabej” filloi funksionimin e tij mbi bazen e departamenteve. Sipas Vendimit të Ministrisë së Arsimit nr.128, datë 27.10.1994 filluan të funksionojnë tre Fakultete dhe 13 Departamente.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokaster është një universitet i Akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr.67, datë 21.09.2017 “Për akreditimin e parë të institucionit të Arsimit të Lartë, Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokaster.

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokaster, Senati Akademik i Universitetit ka miratuar dhe rregulloren e saj:

Pranimi i studentëve aktualisht bëhet mbi bazen e Matures Shtetërore. Studentet mund të ndjekin studimet me kohe të plote.

Sot në vitin akademik 2019-2020 UGJ ka 3 fakultete si Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Fakulteti Ekonomik si dhe 43 programe studimi, nga këto 18 programe të ciklit të parë, 18 programe të ciklit të dytë Master në mesuesi, Master Profesional, 4 programe në Master i Shkencave; dhe 1 program i ciklit të tretë, “Doktoratë në albanologji”; dhe 6 programe profesionale 2-vjeçare.

UGJ përbëhet nga fakultetet, departamentet, si dhe njësi të tjera ndihmëse e shërbimi, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e Universitetit.

UGJ është i organizuar në njësitë mësimore-shkencore si më poshtë:

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE:

- 1. Departamenti i Gjuhës Shqipe**
- 2. Departamenti i Letërsisë**
- 3. Departamenti i Gjuhëve të Huaja**
 - a. Grupi mësimor e kërkimor i Letërsisë e Qytetërimit Anglez
 - b. Grupi mësimor e kërkimor i Gjuhësisë Angleze
 - c. Grupi mësimor e kërkimor i Metodikës dhe Gjuhës dhe kultures Italiane
- 4. Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë**
 - a. Grupi mësimor e kërkimor i Historisë
 - b. Grupi mësimor e kërkimor i Gjeografisë
- 5. Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek**
- 6. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Metodologjisë së Mësimdhënies**
 - a. Grupi mësimor e kërkimor i Pedagogji - Psikologjisë
 - b. Grupi mësimor e kërkimor i disiplinave Artistike Sportive

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

- 1. Departamenti i Matematikës dhe Informatikës dhe Fizikës**
 - a. Grupi mësimor e kërkimor i Analizës Matematike dhe Matematikës së Zbatuar
 - b. Grupi mësimor e kërkimor i Algjebër-Gjeometrisë dhe Informatikës
 - c. Grupi mësimor i Fizikës
- 2. Departamenti i Biologji - Kimisë**
 - a. Grupi mësimor e kërkimor i Biologjisë
 - b. Grupi mësimor e kërkimor i Kimisë dhe Metodikave të Mesimdhënies
- 3. Departamenti i Infermierisë**

FAKULTETI EKONOMIK

- 1. Njësia bazë e Kontabilitet Finances**
- 2. Njësia bazë e Administrimit Publik**
- 3. Njësia bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit**

Universiteti i Gjirokastrës në jetën e tij 50 vjeçare Universiteti i Gjirokastrës ka diplomuar me mijra studente në të dy format e studimit, të cilët shërbejnë në fusha të ndryshme të dijes dhe shkencës, duke dhënë kështu një kontribut të vyer në zhvillimin arsimor, ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në veprimtarinë mësimore e shkencore të Universitetit të Gjirokastrës japin kontributin e tyre rreth 130 pedagogë të brendshëm, pedagogë të ftuar dhe punonjës ndihmës mësimor - shkencor. Pjesa dërmuese e stafit akademik kanë kryer studime, kualifikime e specializime jashtë shtetit, fale edhe lidhjeve të shumta që UGJ ka krijuar me universitetet e vendeve të tjera.

Universiteti është i pajisur me rrjetin e internetit, laboratore, kabinete dhe një bibliotekë të pasur shkencore. Gjithashtu ai shërben edhe si një qendër e rëndësishme kërkimore, shkencore e botuese. Pedagoget e tij kanë qenë e janë pjesëmarrës aktive në konferenca, sesione shkencore e në botime të ndryshme brenda e jashtë vendit.

Ai nxjerr edhe buletin shkencor “Kërkime Universitare”.

Buletini shkencor “Kërkime Universitare”, është revistë periodike e Universitetit “E Çabej” e cila përfshin botimet e tre fakulteteve: FESHSH, FSHN dhe FE.

Universiteti ynë është anëtar i rrjetit të Universiteteve shqipfolëse dhe i Unionit të Universiteteve Juglindore.

Universiteti ynë ka pasur dhe vazhdon të ketë lidhje dhe bashkëpunim me të gjitha universitetet e tjera të vendit si dhe ka nënshkruar protokolle të bashkëpunimit me Universitetin e Janinës (Greqi), të Leccës (Itali), të Athinës (Greqi), Kolegjin “Santa Mary” të Universitetit “Ave Maria” Michigan Detroit (SH B A) si dhe me Universitetin e Qipros.

Universiteti i Gjirokastrës ka kontakte të mira bashkëpunimi me Universitetet e Patres e Selanikut (Greqi), të Maceratës (Itali), etj. Ai u përfshi në shumë programe bashkëpunimi në kuadrin e projekteve Europiane “JEP”, “TEMPUS”, “PHARE”, “INTERREG I,II,III” SEE etj.

Gjithashtu bursat individuale që kanë përftuar pedagogët tanë në kuadrin e programit “TEMPUS” kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e kualifikimit dhe të përvojës së tyre pedagogjike-shkencore si dhe në krijimin e kontakteve me mjaft pedagogë të universiteteve të vendeve të tjera.

Mbi bazën e përvojës dhe arritjeve të deritashme universiteti ka kryer disa studime që kanë lidhje me zhvillimin perspektiv të tij, qoftë në drejtim të ristrukturimit aq edhe në atë të zgjerimit me programe të reja studimi dhe veprimtari të tjera. Gjithashtu synohet ndërkombëtarizimi i institucionit në kuadrin të Erasmus Plus për mobilitetet e studenteve dhe stafit akademik duke fituar përvoja e praktika të reja në procesin mësimor.

MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

2. Misioni.

Misioni i UGJ-së përqëndrohet në qëllimin kryesor, që lidhet me nevojën për ndryshim e transformim dhe për krijimin e kapaciteteve reale për shoqërinë. Konkretisht ky mision është përqëndruar në:

- Përgatitjen e mësuesve për të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar;
- Përgatitjen e infermjerëve të përgjithshëm dhe infermjerëve mami me arsim të lartë;
- Përgatitjen e specialistëve të lartë të ekonomisë;
- Përgatitjen e specialistëve të lartë të Teknologjise se Informacionit
- Përgatitjen e specialistëve ne programe profesional 2 vjecar
- Të shërbejë si një qendër e rëndësishme kërkimore-shkencore dhe botuese në Rajonin Jugor.

3. Vizioni.

Universiteti synon t'i përshtatet e t'i paraprijë zhvillimit shoqëror e ekonomik të vendit. Ai synon të kthehet në një qendër të edukimit të vazhdueshëm për Rajonin e Jugut. UGJ-ja do të vazhdojë të jetë qendër e fuqishme për arsimimin dhe kërkimin shkencor të orientuar nga tregu i punës, nga reformat social-ekonomike dhe nga standartet e reja të integritimit evropian.

Mbi bazën e përvojës dhe arritjeve të deritanishme Universiteti ka kryer disa studime që kanë lidhje me zhvillimin perspektiv të tij, qoftë në drejtim të ristrukturimit, aq edhe në atë të zgjerimit me programe studimi e veprimtari të tjera.

C- PRIORITETET STRATEGJIKE

Niveli i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor në Universitetin e Gjirokastrës do të kenë si objektiv kryesor përpjekjen e vazhdueshme për t'i paraprirë dinamikës së ndryshimeve të shoqërisë shqiptare dhe prirjeve bashkëkohore evropiane për t'iu përgjigjur plotësisht nevojave të së ardhmes së shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë si dhe perspektivave të Rajonit të Gjirokastrës në veçanti:

- duke pasuruar e zhvilluar vazhdimisht burimet njerezore dhe rritjen e përmiresimin e vazhdueshëm për rritjen e kulturës së cilesise;

- duke zgjeruar shumëllojshmërinë e shërbimeve dhe misioneve pasi të bëhen ndryshime edhe në bazën ligjore të arsimit të lartë;
 - duke rritur në mënyrë graduale cilësinë dhe nivelin e punës shkencore si bashkëpunimin me universitetet e qendrat kërkimore shkencore si dhe institucionet partnere.
 - duke orientuar veprimtarinë e universitetit për zhvillimin e rajonit të Gjirokastrës;
 - duke konsoliduar dhe rritur kapacitetet ekzistuese që ka Universiteti;
 - duke i edukuar studentët drejt një mendimi krijues, të lirë e të pavarur si dhe për një jetë qytetarie aktive.
1. Çelja e programeve të reja 2-vjeçar të orientuar në drejtimin profesional, si një nga rrugët për përmbushjen e rolit të Universitetit të Gjirokastrës në mbështetje të institucioneve rajonale si dhe bizneseve të ekonomive lokale.
- studimi i nevojave që ka tregu i punës për specialistë të kualifikuar të fushave të ndryshme, si specialistë, teknikë, ekonomistë, mësues, librarë etj.;
 - duke i hapur në kohë këto programe për zgjidhje të menjëhershme;
 - synimi për t'i shpënë këto programe atje ku janë nevojat dhe kushtet më të përshtatshme.
 - Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.

Të gjitha të dhënat dhe vlerësimet gjatë këtyre viteve të tranzicionit e kanë renditur papunësinë si një ndër problemet kryesore të shqiptarëve. Si rrjedhim, qeveria shqiptare me të drejtë e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe Direktivat e Bashkimit Europian, Strategjisë Evropiane të Punësimit 2020 si dhe kërkesave për integrimin europian të Shqipërisë.

Në këtë aspekt njësitë bazë pranë UGJ-së janë përpjekur që krahas programeve ekzistuese dhe me traditë në sistemin tonë arsimor të bëjnë edhe riorganizime dhe hapje të programeve të reja. Konkretisht gjatë vitit të kaluar, në përshtatje me legjislacionin në fuqi, u riorganizuan dhe filluan me program të ri programet e ciklit të dytë 'Master', "Master Profesional" dhe u hapën 3 programe të reja për ciklin e dytë dhe 6 programe 2-vjeçare me karakter profesional.

Nisur edhe nga fakti se arsimiti i lartë profesional është ajo shkallë e nivelit arsimor, e cila kombinon shkathhtësitë praktike me kurrikula teorike dhe përgatit studentët për tregun e punës, nga analiza e tregut të punës u pa e arsyeshme dhe u realizua hapja e programeve studimore, me karakter

profesional "Udhërrëfyes turistik" dhe "Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3vjeç)" "Ndihmës ekonomist" "Asistent Administrativ" dhe "Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike" dhe : Librar dhe bibliotekar" . Hapja e këtyre programeve profesionale u motivua në rradhë të parë nga dëshira për t'u ofruar gjithë maturantëve një mundësi më shumë për të studiuar në një fushë të arsimit profesional. Si dhe një mundësi konkrete që afron tregu i punës. Programet studimor, me karakter profesional synojnë t'u përgjigjen këtyre sfidave të shoqërisë që janë edhe prioritet për qeverinë shqiptare me qëllim nxitjen e punësimit si kolona kryesore e sistemit të mirëqenies sociale.

1. Çelja e programeve të reja të studimit të Ciklit të parë, të ciklit të dytë si Master Profesional dhe Master Shkencor dhe Ciklit të tretë Doktoraturë.
2. Krijimi i mundësive për realizimin në të ardhmen të formës së studimit të vazhduar.
3. Rritja e mëtejshme e autonomisë së Universitetit.
4. Hapja ndaj komunitetit dhe grupeve të interesit, duke tërhequr mendimin e tyre lidhur me zgjerimin e Universitetit dhe buxhetin; pershtatja e metodave dhe niveleve të financimit në mënyrë që të inkurajohet tërë sistemi për arritjen e objektivave të përgjithshme; konkurrimi përmes projekteve të ndryshme në shkallë rajonale dhe më gjerë; gjetja e mekanizmave për menaxhimin më të mirë të njësive kryesore të universitetit dhe për sigurimin e llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme sa më transparente.

RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE EKZISTUESË TË STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TË REJA

A. Ristrukturimi i programeve ekzistuese të studimit

- Ristrukturimi kaloi përmes një procesi të vështirë për shkak të koncepteve të reja që futeshin në organizimin e tërë veprimtarisë mësimore, por edhe për shkak të moskuptimeve apo kundërshtimeve.
- Ky është një proces që do të vazhdojë edhe më tej, sepse restrukturimi i programeve të studimit do të bëhet edhe për vitet e tjera të studimit.
- Sot në vitin akademik 2019-2020 UGJ ka 3 fakultete si Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Fakulteti Ekonomik, si dhe 43 programe studimi, nga këto 18 programe të ciklit të parë, 18 programe të ciklit të dytë: Master në mesuesi, Master Profesional, 4 programe në Master i Shkencave; dhe 1 program i ciklit të tretë, "Doktoratë në albanologji"; dhe 6 programe profesionale 2-vjeçare.

B. Hapja e programeve te reja të studimit dhe rritja e numrit te studenteve

Zgjerimi i Universitetit “E.Çabej” me programe të reja studimi është një objektivi i rëndësishëm.

1. Arritje e rëndësishme e UGJ-se, është ristrukturimi dhe çelja e programeve të studimit si me poshte:

Sot ne vitin akademik 2019-2020 UGJ ka 3 fakultete dhe keto programe studimi:

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE			
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”			
Nr	Emërtimi i Programit	Cikli i studimit	Forma e studimit
1.	“Bachelor” në Histori – Gjeografi	Cikli i parë	Kohë e plotë
2.	“Bachelor” në Gjuhë – Letërsi Shqipe	Cikli i parë	Kohë e plotë
3.	“Bachelor” në Gjuhë Angleze	Cikli i parë	Kohë e plotë
4.	“Bachelor” në Gjuhë Italiane	Cikli i parë	Kohë e plotë
5.	“Bachelor” në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek	Cikli i parë	Kohë e plotë
6.	“Bachelor” në Histori dhe Gjuhë Italiane	Cikli i parë	Kohë e plotë
7.	“Bachelor” në Mësuesi për Arsimin Fillor Kl I - VI	Cikli i parë	Kohë e plotë
8.	“Bachelor” në Mësuesi për Arsimin Parashkollor	Cikli i parë	Kohë e plotë
PROGRAME TË CIKLIT TË DYTË “MASTER”			
1.	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë , Letërsi dhe Qytetërim Grek	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
2.	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë -Fizikë	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
3.	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë - Informatikë	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
4.	Mësuesi për arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë - Letërsi	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
5.	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë Angleze	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
6.	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Biologji – Kimi	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
7.	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Histori - Gjeografi	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
8.	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë dhe Qytetërim Italian	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
PROGRAME TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”			
1.	“Master Profesional” në Mësuesi Arsimin Fillor Klasa I-V	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
2.	“Master Profesional” në Mësuesi Ndihmës në Edukimin Gjithëpërfshirës	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
3.	“Master Profesional” në Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke	Cikli i dytë	Kohë e plotë
PROGRAME TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE”			
1.	“Master i Shkencave” në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
2.	“Master i Shkencave” në Gjuhesi	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
3.	“Master i Shkencave” në Letërsi	Ciklil i dytë	Kohë e plotë
4.	“Master i Shkencave” në Mësuesi për Arsimin Fillor klasa I – VI	Cikli i dytë	Kohë e plotë

PROGRAME 2 - VJEÇARE ME KARAKTER PROFESIONAL			
1.	Edukatore per zhvillimin e femijerise se hershme 0-3 vjeç	Program profesional	Kohë e plotë
2.	Udhërrëfyes turistik	Program profesional	Kohë e plotë
3.	Librar dhe bibliotekar	Program profesional	Kohë e plotë

PROGRAM I CIKLIT TË TRETË DOKTORATURË			
1.	Doktoraturë në Albanologji	Cikli i tretë	Kohë e plotë

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS			
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”			
Nr	Emërtimi i Programit	Cikli i studimit	Forma e studimit
1.	“Bachelor” në Matematikë – Informatikë	Cikli i parë	Kohë e plotë
2.	“Bachelor” në Matematikë – Fizikë	Cikli i parë	Kohë e plotë
3.	“Bachelor” në Biologji – Kimi	Cikli i parë	Kohë e plotë
4.	“Bachelor” në Infermieri e Përgjithshme	Cikli i parë	Kohë e plotë
5.	“Bachelor” në Fizikë dhe Teknologji Informacioni	Cikli i parë	Kohë e plotë
6.	“Bachelor” në Teknologji Informacioni	Cikli i parë	Kohë e plotë
7.	“Bachelor” në Infermieri Mami	Cikli i parë	Kohë e plotë
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË “MASTER SHKENCOR”			
1.	“Master i Shkencave” në Biologji Mjedisi dhe Zhvillimi	Cikli i dytë	Kohë e plotë

FAKULTETI EKONOMIK			
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”			
Nr	Emërtimi i Programit	Cikli i studimit	Forma e studimit
1.	“Bachelor” në Kontabilitet Finance	Cikli i parë	Kohë e plotë
2.	“Bachelor” në Administrim Publik	Cikli i parë	Kohë e plotë
3.	“Bachelor” në Turizem	Cikli i parë	Kohë e plotë
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”			
1.	“Master Profesional” në Kontabilitet -Financë	Cikli i dytë	Kohë e plotë
2.	“Master Profesional” në Administrim Publik	Cikli i dytë	Kohë e plotë
3.	“Master Profesional” në Turizëm	Cikli i dytë	Kohë e plotë
PROGRAME 2 - VJEÇARE ME KARAKTER PROFESIONAL			
1.	Program profesional në Ndhmës Ekonomist	Program profesional	Kohë e plotë
2.	Program profesional në Asistent Administrativ	Program profesional	Kohë e plotë
3.	Program profesional në Asistent – Menaxher në Shërbimet Turistike	Program profesional	Kohë e plotë

Në të ardhmen do të punohet për hapjen e masterave shkencorë në:

- Matematikë (Departamenti i Matematikë dhe Informatikës dhe Departamenti i Fizikës)
- Gjeografi (Departamenti i Gjeografisë dhe Departamenti i Historisë)

a. Doktoraturë në:

- Matematikë (Departamenti i Matematikë dhe Informatikës dhe Departamenti i Fizikës)
- Biologji (Departamenti Biologjisë dhe Departamenti i Kimisë)
- Histori (Departamenti i Historisë dhe Departamenti i Gjeografisë)
- Gjeografi (Departamenti i Gjeografisë dhe Departamenti i Historisë)

b. Do të çelen këto programe studimi të Arsimit të Lartë jo universitar:

- a. Menaxhim të Pasurive Arkeologjike (Departamenti Histori- Gjeografi)
- b. Menaxhim Biznesi (Departamenti Ekonomik)
- c. Menaxhim Mjedisi (Departamenti Biologji - Kimi)
- d. Informatikë – Ekonomike (Departamenti i Matematikë- Informatikës dhe Departamenti i Fizikës)
- e. Guidator i guidave turistike (Departamenti Ekonomik, Departamenti i Gjeografisë dhe Departamenti i Historisë)

Në kuadër të programeve të formimit të vazhduar do të punohet për t'u hapur këto kurse:

- a. Kurs 6 mujor për kompjuterizimin e kontabilitetit sipas teknologjive të reja (*Departamenti Ekonomik në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës*).
- b. Kurs 3 mujor me punonjësit e pushtetit vendor për problemet e administrimit publik (*Departamenti Ekonomik*).
- c. Kurs 3 mujor për trajnimin e agjencive turistike (*Departamenti Ekonomik*)
- d. Kurs 6 mujor për përgatitjen e specialisteve për drejtimin e shkolles si drejtor shkolle, inspektor arsimit etj. (*Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies*)

Rritja e numrit të studenteve në programet e studimit të UGJ-së është një objektivi i rëndësishëm. Per kete kerkohet:

- a. Persosja e mekanizmave te Matures Shteterore, duke u bazuar ne modelet me te perparuara te vendeve te tjera, si mjet nepermjet te cilit sigurohet hyrja ne IAL ne bashkepunim me Agjencine e Vleresimit te Arritjeve.
 - b. Përmirësimi i vazhdueshëm i punës së QIKS dhe Alumni, i cili do te orientohen e ndihmojë kandidatet per te ardhmen e tyre.
 - c. Dhënia e informacionit për kandidatët e interesuar që kërkojnë të bëjnë zgjedhjet e tyre per programet e studimit Arsimin e Larte.
 - d. Zhvillimi i modularizimit dhe transferimit te krediteve, per te siguruar zgjedhje reale dhe mundesi transferimi si brenda UGJ- së po ashtu edhe midis UGJ-së dhe universiteteve të tjera.
 - e. Stimulimi financiar i studenteve qe ndjekin studimet ne te ashtuquajturat programe studimi te veshtira “ te papreferuara”, i studenteve qe vijne nga shtresa sociale ne nevojë si dhe te studenteve ekselente
4. **Universiteti i Gjirokastrës ka një raport pedagog/studente 1 me 12**, nderkohe qe ky raport ne shkalle kombetare eshte 1 me 26, ndersa BE e ka ate 1 me 20. Universiteti i Gjirokastrës i ka te gjitha mundesite qe te realizojë **objektivin e Strategjise Kombëtare të Arsimit të Lartë** për rritjen vjetore te numrit te studenteve ne formen e studimit me kohe te plote ne shkalle kombetare deri ne vitin 2025, duke rritur numrin e studenteve ne programet ekzistuese te studimit apo nepermjet hapjes se programeve te reja te studimit.

PERMIRESIMI I INFRASTRUKTURES SE UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”

Në bazë të sipërfaqes aktuale të mjediseve mësimore dhe çlodhëse, në vitin akademik 2020-2025 për çdo student te shkencave mjekesore llogariten mbi 5 m², per te tjere mbi 3 m² duke plotesuar normat ligjore mbi siperfaqen.

Përgatitja e projekteve për ndërtimin e mjediseve për mësim, mjediseve të punës për pedagogët dhe krijimin e kushteve normale për administratën e Universitetit, që do të çojë në arritjen e standardeve:

1. Rikonstruksion ish Shtepia e Oficerave si Godinë e re universitare me sipërfaqe ndërtimi 3825 m²,

3. Rikonstrukcion i laboratoreve të Biologjisë, Kimisë, Fizikës, Informatikës dhe pajisja e plotë e tyre me bazë materiale dhe laboratorike.
4. Ngritja e laboratorëve të reja:
 - Laboratori Kërkimor – Shkencor pranë Departamentit Biologji – Kimi.
 - Laboratori Kërkimor – Shkencor pranë grupit mësimor- shkencor të Fizikës.
 - Laboratore te Gjeografise
 - Laboratore te Infermierise

Në këtë mënyrë do të arrihet që kapaciteti i ndërtesave, pajisjeve dhe bibliotekave si dhe cilësia e shërbimit të ofruar prej tyre të shkojë drejtë standardeve rajonal

REKRUTIMI I STAFIT TE RI AKADEMIK

1. Në bazë të nevojave për vitin akademik 2020 - 2025 duke patur parasysh dhe hapjen e programeve te reja te studimit universitar dhe jo universitar do te jete prioritet rekrutimi i pedagogëve të rinj, sipas kriterëve të propozuara nga departamentet dhe te miratuara nga Senati Akademik sipas statutit dhe rregullores se brendshme te UGJ, duke synuar rekrutimin e pedagogëve të kualifikuar ose që janë në proces kualifikimi.
2. Në kuadër të strategjisë për thithjen e trurit, “*Brain Gain*”, universiteti do të parashikojë çdo vit kuota për vende të lira pune, për të punësuar personel akademik , i cili:
 - ka përfunduar me vlerësim mbi mesataren studimet e doktoratës dhe ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” në universitete të huaja, të akredituara nga agjenci të njohura në shkallë ndërkombëtare;
 - pas përfundimit të studimeve të doktoratës ka qenë i punësuar në profesion në një universitet perëndimor ose qendër kërkimore.
3. Per çdo vit akademik nje pjese e mire e ngarkeses mesimore do te perballohet nga pedagoge me kohe te pjesshme dhe te ftuar, duke synuar aktivizimin e pedagogeve cilesor, e specialisteve te afte nga komuniteti si dhe te specialisteve te huaj nepermjet marreveshjeve, projekteve, protokolleve dhe programeve te bashkepunimit me universitetet europiane dhe boterore

4. Shumica e personelit të ri akademik, të kërkuar nga zgjerimi i sistemit (personelit shtesë), do të përqendrohet në **rolin mësimdhënës**, kryesisht në ciklin e parë dhe në programet e profesional 2 vjecar.

MESIMDHENIA DHE TE NXENIT

Objektivat:

Procesi mesimor kërkon që në kuadrin e përmirësimit të cilësisë së të mesuarit të punohet në drejtim të:

1. Modernizimit të metodave dhe teknologjive të mesimdhënies, duke synuar në metodat ndërvepruese dhe të përqendruara tek studentet që zhvillojnë tek këta të fundit ato shprehje të kompetencave që u duhen atyre për të ardhmen.
2. Përmirësimit dhe pasurimit të përmbajtjes së programeve mesimore dhe ligjeratave me të dhëna të reja bashkëkohore të shkencës.
3. Pajisjes së të diplomuarve me shprehje të përgjithshme dhe të transferueshme, si ato të analizës, të të menduarit, të arsytimit, paraqitjes dhe komunikimit.
4. Përmirësimit të kurrikulave në mënyrë të vazhdueshme për t'i bërë ato sa më fleksibile në raport me detyrat që shtrihen kohë përpara specialisteve të tjerë.
5. Përmirësimit të bazës materiale e laboratorike me aparaturo bashkëkohore
6. Përmirësimi të mjediseve funksionale laboratorike në të ardhmen (në vijim).
7. Rritjes së fuqisë mbështetëse të teorisë me nivelin praktik – laboratorik duke fuqizuar laboratorët ekzistues.
8. Ristrukturimit të departamenteve dhe programeve të studimit për të gjetur homologe në botë.
9. Rritjes së pjesëmarrjes së studenteve në punën kërkimore-shkencore dhe në bashkëpunimin mes tyre dhe pedagogëve.
10. Përmirësimit të cilësisë së praktikave profesionale dhe atyre në terren.
11. Pasurimit të bibliotekës me literaturë bashkëkohore dhe përmirësimit shërbimit cilësor të studentëve dhe pedagogëve në mjediset e saj.
12. Shfrytëzimi i bibliotekës dixhitale kombëtare nga studentë dhe pedagogë.

Veprimet që do të ndërmerren:

1. Evidentimi i përmbajtjes së vjetëruar të mesimdhënies nga çdo departament dhe mbi këto baze programimi dhe realizimi i trajnimit të nevojshëm të personelit akademik.

2. Kualifikime jashte shtetit, sidomos shkëmbime afatshkurtra të personelit akademik me universitete të huaja me të cilat Universiteti i Gjirokastrës ka marrëdhënie bashkëpunimi, sidomos me universitetet perëndimore, si nje menyre efikase për të zhvilluar shprehitë mësimdhënëse të pedagogëve tanë.
3. Organizimi i shkëmbimit dhe perhapjes të përvojës se fituar per metodat e mesimdhënies të pedagogëve që kryejnë kualifikimin pedagogjik e shkencor jashtë shtetit.
4. Vlerësimi i reagimit të studentëve për metodat e mësimdhënies të pedagogëve me anë të anketimeve të herëpashershme, nëpërmjet këshillave studentore etj. dhe publikimi i këtyre vlerësimeve për të ndrequr të metat e vërejtura. (2 herë ne vit, Rektorati).
5. Fuqizimi dhe mirefunksionimi i Njesise se Sigurimin te Brendshëm të Cilësisë, e cila do të zhvillojë dhe promovojë performancën e personelit akademik. Hapja dhe plotësimi i **“Vleresimit te Punes se Pedagogut”** per çdo pedagog në kuadrin e përgatitjeve për futjen e treguesve konkretë të kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit që ofron universiteti ynë. Mbi këtë bazë departamentet dhe organet e tjera drejtuese në fakultete do të kontrollojnë përditësismin e kurrikulave, do të bëjnë vlerësimin e personelit akademik, sikurse e përcakton Ligji i Arsimit të Lartë dhe do të programojnë trajnimin e nevojshëm të personelit akademik.
6. Ngritja e nje qendre studimore me ndikim ne fushen e punesimit te laureateve te Universitetit “E.Çabej” si dhe ne evidentimin e problematikave dhe sugjerimeve lidhur me metodat, planet dhe kurrikulat mesimore.
7. Unifikimi i planeve dhe programeve mesimore me sihomologet tane ne zbatim te Ligjit te arsimit te larte 80/2015.
8. Fitimi i gradave e titujve akademik nga anetaret e departamenteve (gjithesej mbi 50% e stafit).
9. Kompletimi cilesor i personelit akademik te nevojshem.(ne vijim)
10. Pasurimi i vazhdueshem i bibliotekes me literature shkencore e pedagogjike dhe dixhitalizimi i saj, duke e kthyer ate ne qender burimore e mediateke per studentet, pedagoget e qytetaret .
11. Rritja e fondeve qe do te harxhohen per bazen materiale e laboratorike (nga buxheti grant, nga te ardhurat e krijuara si dhe nga pjesemarrjet ne projekte, ne vijim)
12. Zgjerimi i përdorimit te mjeteve didaktike dhe sidomos atyre audiovizive ne procesin e mesimor.(ne vijim). Per kete do te realizohet:
 - Vendosja e videoprojektorëve në 10 salla leksionesh.
 - Pajisja e departamenteve me të paktën një kompjuter për çdo pedagogë, një printer dhe një fotokopjues për çdo grup mësimor – shkencor.

- Ristrukturimi i laboratorëve aktual.
- Përgatitja e projekteve për labororet e reja (2 laboratorë të Departamentit të Biologji – Kimi, një laborator të Fizikës dhe një laborator të Departamentit të Infermjerisë)

13. Venia ne dispozicion te studenteve e teksteve, perkthimeve e cikleve te reja te leksioneve.
14. Permirësimi i dokumentacionit zyrtar shkollor neper sekretarite mesimore sipas modeleve perendimore.(ne vijim)
15. Krijimi i zyres se informacionit dhe informimit studentor lidhur me gjithe aktivitetin mesimor e shkencor ne universitet.

Kufizimet qe duhen perballuar:

1. Mungesa e pajisjeve te pershtatshme per nje mesimdhenie moderne.
2. Mungesa e fondeve te duhura per blerjet ne bazen materiale, etj.
3. Mungesat e fondeve e lehtesive per levizjen e lire te personelit akademik per te kontaktuar, konsultuar e krijuar bashkepunimin e nevojshem, shkembyer eksperienca e pervoja me homologet perkates neper bote.
4. Mungesa e specialisteve te ngushte brenda fushave perkatese si dhe e literatures specifike ne keto nivele.
5. Mungesa e mjediseve te pranueshme te punes per stafin akademik e shkencor (mjedise, telefonizim, etj.), gje per te cilen se fundi po jepen zgjidhje.
6. Plan-botimet shume te kufizuara e te vogla.
7. Kufizimet financiare per kryerjen me rentabilitetin e duhur te praktikës profesionale apo asaj ne terren.
8. Mungesa e shkollave ushtrimore me varesi edhe te universitetit.

Perballimi i ketyre kufizimeve:

1. Te rritet pesha e fondeve ne favor te bazes materiale .
2. Te rriten financimet per krijimin e mjediseve te reja te punes.
3. Rritja e raporteve te kembimit te literatures me homologet tane ne bote mbi bazen e lidhjeve,projekteve e aktiviteteve te perbashketa.
4. Te rriten perpjekjet e personelit akademik per permiresimin dhe pasurimin e bazes materiale qe varet nga forcat tona.
5. Rritja e cilesise se punes nga ana e personelit akademik.

Matja e arritjeve:

1. Me % e personelit akademik te perfshire ne veprimtari zhvillimi per te permiresuar stilin dhe metodat e mesimdhenies.
2. Me numrin e personelit akademik te trajnuar per te zhvilluar shprehite e mesimdhenies.
3. Me % e rritjes se cilesise se procesit te nxenit e kerkimit nen driten e ndryshimeve te reja.
4. Me % e mases se kurrikulave te mbuluara e ilustruara nga baza materiale e didaktike.
5. Me numrin e individeve qe fitojne grada dhe tituj akademik.
6. Me sasine e botimit te teksteve, artikujve, monografive, etj.. nga personeli akademik.
7. Me sasine dhe cilesine e mjediseve te punes mesimore e shkencore
8. Me nivelin cilesor te pergatitjes se studenteve ne fushat perkatese.
9. Me % e pjesemarrjes se studenteve ne kerkimin shkencor.
10. Me numrin e studenteve te pranuar dhe numrin e atyre qe diplomohen
11. Perputhja e te diplomuareve me nevojat e tregut te punes dhe me politikat e punesimit
12. Nepermjet realizimit te ekuivalentimit te diplomave me vendet e Evropes.
13. Nepermjet raportit te vleresimit te brendshem te cilesise si dhe vleresimeve dhe opinionit te studenteve per mesimdhenien.
14. Nepermjet kontroleve, vleresimeve dhe anketimeve te konkludohet mbi aftesite e perballimit te problematikave qe u dalin ne jete ne qendrat e tyre te punes specialisteve te pergatitur nga ne.

KERKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE

Strategjia e UGJ për kërkimin shkencor

UGJ, në fushat e studimit dhe të kërkimit shkencor harton dhe ndjek një strategji, e cila është në funksion të politikave të universitetit.

Aktiviteti në kuadrin kërkimor shkencor në UGJ, zhvillohet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (Kreu VIII, Neni 93 “Kërkimi Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë”).

Kjo strategji konkretizohet hollësisht me: planifikime e zbatime specifike gjatë çdo viti akademik; studime; publikime; projekte; organizimin e konferencave; trajnimeve si dhe veprimtari të tjera

shkencore. Kjo veprimtari ka si qëllim të mbështesë stafin akademik për kualifikimin e tij. Ajo garanton integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies.

Ka institucionalizuar dhe përmirësuar një sistem të angazhimit, matjes dhe vlerësimit të punës kërkimore shkencore të anëtarëve të personelit akademik në përpjekje për të përforcuar dimensionin e kërkimit shkencor në UGJ.

UGJ kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese

Kërkimi shkencor në UGJ është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësim-nxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore, me qëllim që të formohen shprehi të punës dhe të metodave kërkimore shkencore tek studentët.

Nëpërmjet kësaj strategjie, UGJ synon shndërrimin në një *qendër ekspertize* në fushën e studimeve shoqërore, ekonomike dhe teknologjisë së informacionit.

Synim i mëtejshëm është kthimi i UGJ në një *qendër ekselence* që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal.

Strategjia e Kërkimit Shkencor, dhe burimet e vëna në dispozicion për jetësimin e saj, *pasqyrojnë filozofinë e realizimit të synimeve kërkimore të UGJ.*

Specifikisht, për realizimin e projekteve kërkimore të stafit akademik UGJ ka vendosur në dispozicion një *grant kërkimor të konsiderueshëm*. Nëpërmjet këtij granti UGJ synon që projektet kërkimore ti shërbejnë zhvillimit profesional, avancimit në sistemin e karrierës akademike në grada e tituj të stafit akademik, si dhe në rritjen e reputacionit të UG, sa i takon kërkimit shkencor.

Universiteti “E.Cabej” synon:

- të shndërrohet në një **universitet të bazuar në kërkimin shkencor** në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).
- të shndërrohet në një qendër të rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare e rajonale në kooperimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave të arsimit të lartë, etj;
- të përmirësojë infrastrukturën në mbështetje të kërkimit shkencor, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH (në vijim Ligji 80/2015).

- të përcaktojë prioritetet e kërkimit shkencor nga njësitë bazë, referuar përcaktimit të objektivave të veprimtarisë kërkimore të çdo anëtari të stafit akademik, duke synuar përputhjen e objektivave të kualifikimit shkencor individual me objektivat kërkimore-shkencore të njesisë bazë, njesisë kryesore , nevojave të zhvillimit rajonal;
- të rrisë standartin e kërkimit duke promovuar standartet më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe integritetin etik në punën kërkimore;
- të orientojë kërkimin në të gjitha fushat dhe kategoritë që i përgjigjen zhvillimit social-ekonomik të rajonit;
- standardizimin e “profilin të pedagogut” në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015, akteve nënligjore në zbatim të tyre;
- Vlerësimin me pikë/kredite dhe me kritere unike të veprimtarisë kërkimore-shkencore e botuese, për çdo vit akademik e për çdo pjesëtar të personelit akademik, për: (1) monografi e tekste mësimore universitare, të bazuara në standarde akademike dhe të diferencuar për autorët e parë e bashkautorët; (2) artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore në tri nivele (a) kombëtare, (b) ndërkombëtare, (c) me faktor impakti, të diferencuar për autorët e parë e bashkautorët ;(3) kongrese e konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, simpoziume, forume etj, të diferencuar për autorët e parë e bashkautorët;(4) pjesëmarrje në aktivitete shkencore e botuese, si: pjesëmarrja në projekte kërkimore, drejtimi i periodikëve shkencorë (si kryetar apo anëtar i Bordit Botues), drejtimi i aktiviteteve shkencore (si kryetar apo anëtar i komisioneve organizatore); (5) referime shkencore, prezantime, leksione të hapura etj, të zhvilluara në njësitë bazë, apo në nivele të tjera të universitetit dhe në universitete të tjera; (6) çdo aktiviteti të ideuar dhe shpallur nga Rektorati apo organe të tjera drejtuese; (7) çdo aktivitet tjetër që vlerësohet, në nivel njësie bazë në përputhje me specifikat e tij, si aktivitet shkencor apo krijues e që pasuron dosjen personale të veprimtarisë kërkimore shkencore e botuese të personelit akademik;
- hartimin e një kalendari vjetor të aktiviteteve shkencore-kulturore (konferenca kombëtare e ndërkombëtare, seminare, simpoziume, leksione të hapura, referime shkencore, ëorkshop-e, shkolla verore etj);
- përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor e konsideruar si mundësi “e artë” për të realizuar objektivat të kërkimit shkencor, si kërkesë për formimin e tyre profesional dhe qytetar, si rrugë për të rritur shkallën e përvetësimit të programeve mësimore, si një mënyrë

për pasurimin e CV-së së tyre në kohën e studimeve universitare dhe orientimin e tyre në tregun e punës;

- organizimin dhe nxitjen e lëvizjeve sociale, kulturore, sportive, mjedisore etj, për gjallërimin e gjithë jetës universitare;
- organizimin dhe përafrimin e veprimtarive shkencore-kulturore në UGJ, me kalendarin e ngjarjeve të vecanta kombëtare dhe ndërkombëtare për impaktin përmbajtësor dhe atë mediatik;
- pasqyrimin e aktiviteteve në kohë reale në faqen zyrtare të UGJ si dhe mediatizimin e aktiviteteve dhe gjithë veprimtarisë së UGJ-së në të gjitha format e mundshme (media, media sociale, ëeb-e), për rritjen e impaktit, propogandimin e asaj cka UGJ ofron, si dhe për rritjen e imazhit publik të Universitetit “Eqrem Cabej”;
- të përcjellë debatet publike për edukimin nëpërmjet kontributit të pavarur të mbështetur në punën kërkimore duke mirëpritur dhe mbështetur partneritetin me agjencitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim që të promovojë të mirat publike në edukim;
- të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës Juglindore, vendeve anëtare të Bashkimit European dhe më gjerë, vendeve anëtare të OCDE-së;
- zgjerimin e partneritetit me çdo institucion që nga organizatat lokale partnerë strategjike, partnerë institucionalë, partnerë sipërmarrës etj, që mund të ndihmojnë në përmbushjen e misionit të tij, duke e konsideruar partneritetin si çelësin e suksesit të një universiteti;
- të organizojë dhe ofrojë diploma të përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët;
- të përfshihet në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratoreve, etj.
- angazhimin për të zgjeruar lidhjet ndërkombëtare, sidomos me Universitetet Evropiane për të aplikuar në projekte të përbashkëta për ngritje kapacitetesh në “Erasmus +” , me qëllim të sigurojë më shumë mundësi trajnimi për stafin akademik dhe administrativ, për mbështetje në pajisje dhe laboratorë sipas prioritetit të nevojave që do të përcaktohen.

- angazhimin për aplikime në projekte me objekt kryesor përmirësimin e kurrikulave, siç janë projektet) në “Erasmus +”, donatorë të tjerë të Komisionit Evropian, apo institucioneve financues(ambasadat), si: Italiane, Franceze, Amerikane, Hollandeze, Greke etj. Mbi këto parime, UGJ është shumë i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, proceseve akademike dhe zhvillimit të stafit dhe kërkimit përmes mundësive që ofron ndërkombëtarizimi. Këto synime, UGJ përpiqet t’i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Strategjia e UGJ për kërkimin shkencor parashtrohet:

- të identifikojë Objektivat e Kërkimit Shkencor, fushat prioritare në bashkërendim me Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (në fushat e shkencave natyrore, teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane), të cilat zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik, dhe me politikat sektoriale të zhvillimit.
- të realizojë vlerësimin e veprimtarisë kërkimore – shkencore të njësisë bazë.
- raportin vjetor të institucionit për KSH.

Kërkimi akademik në UGJ ka si qëllim:

- prodhimin dhe organizimin e dijes, zhvillimin e teorive të reja si dhe promovimin, forcimin e veprimtarive kërkimore në shërbim të mjedisit akademik, të bazuara në metodologji të reja e të mirëfillta shkencore;

- zhvillimin dhe inovacionin pedagogjik, i cili ka të bëjë me futjen dhe përdorimin e metodologjive pedagogjike, mjeteve të edukimit dhe materialeve e teknikave mësimore inovative;

- orientoje kërkimin drejt praktikës e cila do të prodhojë dije të reja duke kontribuar në përparimin e efektshëm të praktikës së menaxhimit. Kjo kategori mbështetet në metodologji të bazuara në vëzhgime nga afër dhe të thelluara të situatave komplekse të biznesit, rasteve studimore, anketimeve etj;

UGJ është angazhuar tërësisht në kërkimin, që fokusohet jo vetëm në organizimin e mirë dhe rritjen e kapaciteteve të Universitetit, por edhe në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim

brenda tij, që mbështet përpjekjet kërkimore dhe gjenerimin e një tërësie rrethanash të volitshme për kërkimin në kontekstin e gjerë socio-ekonomik të Shqipërisë, duke u përpjekur të ruajë balancën në zhvillimin e trinomit arsim - kërkim - novacion, në përputhje me kriteret dhe standartet e BE-së.

Politikat e kërkimit shkencor

Universiteti "Eqrem Çabej" si çdo universitet publik shqiptar, krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, përpiqet të realizojë më sukses dhe *kërkimin shkencor* përmes transferës së teknologjisë së informacionit, edukimit të vazhdueshëm etj, dhe si një institucion akademik dhe kërkimor – shkencor, do të vazhdojë të jetë një qendër e fuqishme për arsimimin dhe kërkimin shkencor.

Aktiviteti kërkimor- shkencor në UGJ bazohet, organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", mbështetur në politikat mbi arsimin e lartë të ndjekura nga MASR, i orientuar nga reformat social – ekonomike, nga tregu i punës si dhe nga standartet e reja të integritit europian.

Kërkimi shkencor, si tërësia e veprimtarive që krijojnë dije, përbën një të drejtë të personelit akademik që ushtrohet në kushtet e lirisë akademike, e cila garanton pavarësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Universiteti ofron kushte të përshtatshme dhe mbështet me çdo mënyrë prodhimin e dijes së re, bazë dhe të zbatuar, duke përqëndruar vëmendjen në cilësinë dhe në origjinalitetin e punës kërkimore.

Universiteti yne synon të konvertohet në një qendër rajonale të edukimit dhe kërkimit shkencor. Riorganizimi dhe reformimi i kërkimit shkencor në UGJ konceptohet dhe vlerësohet si faktor themelor për reformimin e veprimtarisë akademike, kërkimore e shkencore dhe njëherazi përcaktues për vendosjen e standarteve europiane.

Njësitë bazë kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore bazë, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, sipas natyrës dhe objektivave specifike të institucionit.

Në veprimtarinë mësimore-shkencore të universitetit japin ndihmesën e tyre rreth 112 pedagogë të brendshëm.

Rreth 50.0% e personelit akademik kanë fituar tituj e grada shkencore dhe pjesa tjetër vazhdon punën për kualifikim. Në UGJ një pjesë mirë e pedagogëve kanë kryer studime, kualifikime e specializime jashtë shtetit, falë lidhjeve të shumta dhe bashkëpunimit që UGJ ka krijuar me Universitetet e vendeve të tjera si: Janinë, Patër, Athinë dhe Selanik në Greqi, Puglia, Lece, Firenze etj, në Itali, në disa universitete të Spanjës (Universiteti IES LAGO Madrid dhe Konsortiumi I Shkollave të Larta Ekonomike Spanjë), Prishtinë në Kosovë, Tetovë në Maqedoni, Toluz III në Francë, "Ave Mary" në Michigan Detroid SHBA, Silezisë në Poloni, Turkut në Finlandë, në Suedi etj.

Pedagogët kanë qënë dhe janë pjesëmarrës aktiv në projekte të ndryshme, në konferenca e sesione shkencore, në botime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, etj.

Universiteti boton Buletinin Shkencor “Kërkime Universitare” e cila është revistë periodike e Universitetit “E Çabej” dhe përfshin botimet e tre fakulteteve: FESHSH, FSHN dhe FE të organizuara në :

1. seksioni i Shkencave Shoqërore dhe të edukimit;
2. seksioni i Shkencave të Natyrës;
3. seksioni i Shkencave Ekonomike.

Duke e konsideruar kërkimin shkencor si kërkim në qëllim dhe funksion të zhvillimit, UGJ në planin e tij strategjik parashikon drejtimet kryesore të kërkimit si dhe fushat konkrete prioritare, si më poshtë:

- a. Mësimdhënia e mësimnxënia;
- b. Metodatat e edukimit në distancë;
- c. Studime dhe kërkime në: analizë matematike, statistikë, biodiversitet, kimi, biologji, trashëgimi natyrore, historike dhe kulturore;
- d. Transformime socio-ekonomike në rajon dhe më gjërë;
- e. Çështje të zhvillimit historik e lingistik (probleme të dygjuhësisë);
- f. Integritet social, kulturor në rajon;
- g. Emigrimi efektet dhe pasojat në popullsisë dhe ekonominë e rajonit të jugut;
- h. Teknologjitë e informacionit;
- i. Problemet e zhvillimit ekonomik të rajonit,
- j. Situata dhe prespektiva e agroturizmit në rajon, etj.

UGJ është angazhuar tërësisht në kërkimin që fokusohet jo vetëm në organizimin e mirë dhe rritjen e kapaciteteve të Universitetit, por edhe në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim brenda tij, që mbështet përpjekjet kërkimore dhe gjenerimin e një tërësie rrethanash të volitshme për kërkimin në kontekstin e gjerë socio-ekonomik të rajonit dhe vendit, duke u përpjekur të ruajë balancën në zhvillimin e trinomit arsim - kërkim - novacion, në përputhje me kriteret dhe standartet e BE-së.

c. Objektivat:

1. Të vendosë veprimtarinë kërkimore shkencore të universitetit në funksion të:
 - a. rritjes së cilësisë së procesit të mësimdhënies, mësuarit gjatë gjithë jetës,

- b. zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Të përdorë perspektivat ndërkombëtare krahasuese në edukim, duke zhvilluar vlerat e shanseve të barabarta, drejtësisë sociale dhe të mirën e përbashkët;
 3. Të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor duke e konsideruar këtë si domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shkollimit universitar;
 4. Të rrisë fondin (buxhetit) në favor të kërkimit shkencor;
 5. Të vazhdojë me ritme të shpejta kualifikimin e stafit akademik pa gradë.
 6. Të përfshirjë më gjërë safin akademik dhe studentorë në projektet kërkimore-shkencore, kombëtare e ndërkombëtare;
 7. Të inkurajojë dhe krijojë një gjenerate të re kërkuesish shkencorë në fushat e politikave sociale, mjedisore dhe ekonomike;
 8. Të vendosë kërkimin në funksion të komunitetit, mjedisit e shoqërisë në tërësi;
 9. Të rrisë cilësinë dhe numrin të botimeve të përgatitura nga anëtarët e Njësisë Bazë (artikuj, monografi, tekste mësimore etj, si dhe cilësisë së tyre;
 10. Të zgjerojë dhe forcojë marrëdhëniet e partneritetit me institucionet vendore, arsimore, bankat, spitalin, bizneset e qarkut, institucione kërkimore-shkencore, trajnuese, botuese etj;
 11. Të zgjerojë kapacitetin e Bibliotekës;
 12. Të mundësojë botimin e të paktën dy revistave shkencore (periodikë) cdo vit Akademik;
 13. Të angazhohet për të siguruar dhe zgjeruar lidhjet ndërkombëtare, sidomos me Universitetet Evropiane për të aplikuar në projekte të përbashkëta për ngritje kapacitetesh në Erasmus +, Horizont 2020, etj, për të siguruar më shumë mundësi trajnimi për stafin akademik dhe administrativ, për mbështetje në pajisje dhe labore sipas prioritetit të nevojave që do të përcaktohen;
 14. “Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit” dhe shqyrtimi i mundësive për krijimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me universitete të huaja;
 15. Hartimin e një kalendari vjetor të aktiviteteve shkencore-kulturore (konferenca kombëtare e ndërkombëtare, seminare, simpoziume, lektorime, leksione të hapura, referime shkencore, ëorkshope etj);
 16. Të orientojë dhe përafrojë veprimtarinë shkencore-kulturore në UGJ me kalendarin e ngjarjeve ndërkombëtare (sipas përcaktimit të OKB, e bashkëngjitur) si dhe kalendarin e ngjarjeve të veçanta (mbarëkombëtare),

- si për domethënien që kanë, ashtu edhe impaktin mediatik;
17. Të pasqyrojë aktivitetet në kohë reale në faqen zyrtare të UGJ, mediatizimin e aktiviteteve dhe gjithë veprimtarisë së UGJ në të gjitha format e mundshme (media, media sociale, ëebe), për rritjen e impaktit, propogandimin e ofertës UGj, si dhe për rritjen e imazhit publik të Universitetit “Eqrem Çabej”;
 18. Të sjellë sa më afër botën akademike me komunitetin dhe biznesin, duke ofruar konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, teknologjinë e informacionit, kërkimin, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije.
 19. Të krijojë nje rrjeti laboratorik në nivel kombëtar për realizimin e një game të gjërë kërkimesh.

Strukturat përgjegjëse për Kërkimin Shkencor

Jetëzimi i Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2020 - 2025 përbën një ndër synimet më të rëndësishme të universitetit tonë.

Për të vënë në jetë vizionin e tij studimor-kërkimor, UGJ ka synuar të ndërtojë dhe përmirësojë në vazhdimësi një infrastrukturë të kërkimit shkencor, për t’i dhënë frymëmarrjen e duhur punës studimore të stafit akademik si dhe bashkëpunimit me institucione analoge nëpërmjet fondeve të akorduara nga institucionet publike, private dhe organizma të tjerë, brenda dhe jashtë vendit.

Sipas Ligjit dhe Statutit të UGJ, kërkimi kryhet nga njësitë bazë koordinuar nga zyrat e Njësive Kryesore. Njësitë bazë hartojnë plane pune, informacione dhe raporte semestrale e vjetore, në përputhje me strategjinë e universitetit për kërkimin shkencor, prioritetet e MASR në fushën e kërkimit shkencor, prioritetet e rajonit për zhvillim, të cilat depozitohen pranë Dekanit të Fakultetit. Pra stafi akademik i UGj-së kryen punë kërkimore-shkencore kryesisht si staf i angazhuar pranë njësive bazë (si kërkues shkencorë, lektorë apo koordinatorë projektesh kërkimore).

Në nivel universiteti, puna kërkimore koordinohet dhe orientohet nga Zv/Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me jashtë në mbështetjen e Zyrës për Menaxhimin e Veprimtarisë Kërkimore-shkencore, Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

UGJ:

- harton strategjinë e kërkimit shkencor të universitetit në përputhje me prioritet e AKKSHI, njësive kryesore dhe bazë ;

- harton programin dhe planin e punës për çdo vit akademik, ku pasqyrohen fushat, drejtimet kryesore dhe afati I veprimeve (bazuar në planin e punës kërkimore- shkencore të njësive kryesore dhe bazë) , që miratohet nga Senati Akademik;
- ndjek dhe kontrollon ecurinë e zhvillimit të punës shkencore dhe projekteve në nivel universiteti;
- ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore për ciklin e tretë të studimeve(doktorale) në njësitë kryesore dhe ato bazë;
- paraqet për miratim në Senatin Akademik projekte kërkimore dhe mësimore duke mbajtur parasysh standardet bashkëkohore
- nxit njësitë bazë për punë kërkimore-shkencore dhe projekte në shkallë universiteti, njësie kryesore apo njësie bazë;
- bashkërendon dhe koordinon veprimtaritë kërkimore të njësive bazë, duke respektuar liritë akademike të stafit akademik;
- ndjek bashkëpunimin shkencor të njësive të UGJ-së me institucione kërkimore shkencore, universitete të tjera(brenda, dhe jashtë vendit), firma, ndërmarrje prodhimi etj;
- nxit promovimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të universitetit;
- aplikon (n.p.m. zyrës së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë) për projekte të përbashkëta ndëruniversitare, ndërrajonale, ndërinstitutionale(institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit);
- kontribuon në nxitjen dhe përfshirjen e stafit akademik dhe studentor të universitetit në këto projekte;
- orienton politikat e veprimtarisë botuese të UGJ, ku përfshihen revistat shkencore periodike.
- raporton në fund të çdo viti akademik, për veprimtarinë kërkimore-shkencore pranë Senatit Akademik ku dhe kryhen vlerësimet përkatëse.

Ky raport ndihmon në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit për faktin se përmban një analizë të hollësishme që vjen si rezultat i analizave të veçanta në çdo fakultet dhe njësi bazë.

Në qëllim të ndërkombëtarizimit të universitetit, për të zhvilluar projekte ndërkombëtare, partneritete strategjike dhe lehtësim aplikimesh për grante kërkimore etj, është ngritur Zyra për Menaxhimin e Veprimtarisë Kërkimore-shkencore, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;

Kërkimi shkencor në universitet bëhet nga njësitë bazë apo grupet mësimore-kërkimore dhe mund të jetë:

- a. Kërkim shkencor bazë pa përdorim të menjëhershëm praktik;
- b. Kërkim shkencor i aplikuar në lidhje të ngushtë me nevojat dhe interesin publik.

Veprimtaria kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies, si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të njësisë bazë dhe Njësive Kryesore të UGJ është përqëndruar në këto drejtime:

- a. Hartimin e planeve dhe programeve të reja mësimore: U realizua hapja e programeve studimore, me karakter profesional “Udhërrëfyes turistik”, “Edukatore për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3vjeç)” “Ndihmës ekonomist” “Asistent Administrativ”, “Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike” si dhe “Librar dhe Bibliotekar”.
- b. Ristrukturimi i planeve dhe programeve ekzistuese: u bë një punë serioze, duke angazhuar të gjithë stafin akademik të njësisë bazë, për përmirësimin dhe ristrukturimin e planeve dhe programeve ekzistuese mësimore si dhe dokumentacionit të nevojshëm për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master Profesional”
- c. Zhvillimin e kurikulave, planeve mësimore, cikleve të ligjëratave, konform udhëzimeve dhe ligjit të arsimit të lartë.
- d. Pjesëmarrjen në veprimtari jashtë universitare të lidhura jo vetëm me performancën arsimore.
- e. Forcimin e punës kërkimore-shkencore të stafit, me qëllim arritjen e objektivave të kualifikimit shkencor.
- f. Përdorimin e metodave dhe teknologjive më të reja në mësimdhënie.
- g. Hartimin dhe përgatitjen e teksteve universitare dhe dispencave mësimore.
- h. Përgatitjen e shkurtuar të programeve mësimore në dy gjuhë.
- i. Prezantimin e cikleve të leksioneve në trajtën e skripteve.
- j. Angazhimin e studentëve në ekspedita për hulumtim dhe grumbullim material kërkimor si dhe në realizimin e analizave laboratorike.
- k. Ngritjen dhe funksionimin e “*Qendrës së trajnimeve profesionale të mësuesve*”

Për mbarëvajtjen më të mirë të procesit mësimor, pajisjes së studentëve me njohuri bashkëkohore, shprehi e kompetenca të domosdoshme për të ardhmen e tyre, duhet:

- më shumë investime për përmirësimin e bazës materiale laboratorike me aparatura bashkëkohore;
- përmirësim të mjediseve funksionale laboratorike.

- vëmendje më e madhe për përfshirjen e studentëve në aktivitete specifike të projekteve.
- bashkëveprim më efektiv me biznesin dhe komunitetin përveç dy misionëve të tjera të UGJ (mësimdhënies dhe kërkimit) për të siguruar një sistem efektiv veprimi.

Produktet në fushën e kërkimit shkencor

UGj, përmes studimit dhe kërkimit shkencor, synon të realizojë qëllimin e vet nëpërmjet kryerjes së punës studimore e kërkimore, trajnimeve, kurseve e konsultave, shërbimeve, veprimtarisë botuese dhe realizimit të projekteve brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunime me institucione të tjera vendore, kombëtare apo ndërkombëtare etj.

Krahas punës për zhvillimin me korrektësi dhe cilësi të mësimdhënies, personeli akademik i UGJ, i ka kushtuar një vëmendje mjaft të madhe veprimtarisë kërkimore-shkencore (individuale dhe në grup) me qëllim kualifikimin e mëtejshëm shkencor.

UGj synon të bashkëpunojë me institucione të tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe të bëhet pjesëmarrës aktiv në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit.

Universiteti ynë, duke synuar të konvertohet në qendër rajonale të edukimit dhe të zhvillimit, përpiqet të realizojë objektivat e veta në këtë drejtim.

Veprimtaria kërkimore-shkencore si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të UGJ është përqëndruar në këto drejtime:

1. Aktiviteti Kualifikues.
 - a. Vazhdimi i punës kërkimore-shkencore.
 - b. Vazhdimi i punës kualifikuese për grada e titujt, etj.
2. Aktiviteti Botues: Artikuj, recenca shkencore për periodikë kombëtarë / ndërkombëtarë.
3. Referime dhe pjesëmarrje në Konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Udhëheqje e temave të diplomës në Master profesional.
5. Pjesëmarrje në projekte, etj.

LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBETARE

Universiteti "Eqrem Çabej", si çdo universitet publik shqiptar, krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, përpiqet të realizojë më sukses dhe dy misionet e tjera: *kërkimin shkencor* dhe misionin e tretë tredimensional atë të bashkëpunimit me sektorë publik e privat të rajonit përmes transferës së teknologjisë së informacionit, edukimit të vazhdueshëm dhe angazhimit social.

a- Objektivat:

1. Rritja e rolit të UGJ-se në ndihmë të zhvillimit ekonomik dhe social, duke ofruar krahas mësimit edhe veprimtari të ndryshme praktike si konsulencë, kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime të tjera, duke përfutur në këtë mënyrë të ardhura shtesë. Klientët potencialë për këto shërbime do të jenë komunitetet dhe bizneset lokale, organet e qeverisjes vendore e qendrore si dhe organizata të ndryshme donatore.
2. Shndërrimi i UGJ-se në qëndër të zhvillimit rajonal në lidhja të forta me komunitetin lokal dhe vemendje të veçantë ndaj nevojave të këtij komuniteti.
3. Tërheqja e mendimit të specialisteve të rajonit në politikat dhe strategjitë e zhvillimit të universitetit, me qëllim ristrukturimin e programeve ekzistuese apo edhe çeljen e programeve të reja të studimit në funksion të nevojave dhe tregut të punës së rajonit.
4. Bashkëpunim më efektiv me Prefekturën, Qarkun, Bashkitë, drejtoritë dhe agjencitë e ndryshme rajonale, OJF-të e ndryshme etj. në funksion të reflektimit të punës së universitetit në interes të komunitetit.
5. Angazhimi i resurseve laboratorike e njerezore të rajonit në funksion të aktivitetit studimor dhe shkencor të universitetit.
6. Të sigurohen fonde investuese në bazën materiale-teknike dhe literaturë nëpërmjet shërbimeve të ndryshme ndaj komunitetit dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare.
7. Të sigurohen bashkëpunime për të zgjidhur një sërë probleme të rajonit që shqetësojnë rajonin e më gjërë.
8. Të shërbejë si qender e kualifikimit të mësuesve, ekonomistëve etj. të rajonit.
9. Të inkurajojë partneritetin dhe integrimin e të rinjve në komunitet për gjetjen e alternativave që do të mundësojnë kohezionin social dhe zhvillimin e qendrueshëm;

b- Veprimet që do të ndërmerren:

1. Organizimi i ëorkshopeve me komunitetin (sipas tematikave e rastit).
2. Organizimi i konferencave të shtypit dhe tryezave të rumbullakta.
3. Ngritja e një komiteti rajonal të politikave të zhvillimit me intelektualët e njohur të rajonit.
4. Trajnime në funksion të sektorit privat në rajon dhe tregut të punës. (në vijim).
5. Hartimi dhe zbatimi i projekteve dhe studimeve të përbashkëta.
6. Të nxisë krijimin e një aleance të suksesshme midis aktorëve kryesorë në rajon, për të mundësuar një dialog të vazhdueshëm midis tyre mbi reformat arsimore, ekonomike dhe zhvillimin e integruar ekonomik në vend dhe më gjerë;
7. Të sjellë më afër komunitetin e biznesit me botën akademike, të ofrojë konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, teknologjinë e informacionit, kërkimin, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije.

ROLI NDERKOMBETAR

UGj synon të bashkëpunojë me institucione të tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe të bëhet pjesëmarrës aktiv në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit.

a- Objektivat:

1. Modernizimi, ndërkombëtarizimi dhe rritja e aksesit të universitetit.
2. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit.
3. Promovimi i kontakteve me institucionet e arsimit të lartë, aftësive njohurive shkencore, ndërkulturore si dhe bashkëveprimin në fushat e interesit të përbashkët.
4. Ngritja në nivele bashkëkohore të metodologjisë së transmetimit të dijeve, njohurive dhe aftësive, referuar modeleve më të mira ndërkombëtare.
5. Modernizimi i politikave të drejtimit dhe administrimit të institucionit.
6. Ngritja e programeve të përbashkëta të studimit në nivel Master(profesional dhe shkencor).
7. Të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës Juglindore, vendeve anëtare të Bashkimit European dhe më gjerë, vendeve anëtare të OCDE-së.

b- Veprimet që do të ndërmerren:

1. Shkëmbim botimesh;
2. Shkëmbimin e stafit akademik në programet e mobilitetit.
3. Shkëmbimin e studentëve të të gjitha niveleve;
4. Aktivitete të përbashkëta kërkimore;
5. Pjesëmarrje në seminare dhe takime akademike;
6. Programe të vecanta afatshkurtra akademike;
7. Programe të zhvillimit profesional;
8. Organizimi i veprimtarive në fusha, për të cilat interesi I përbashkët për bashkëpunim ka lindur ose do të shpallen në vijim.
9. Organizimin e konferencave të përbashkëta shkencore.
10. Organizimin e shkollave apo kurseve verore.
11. Pjesëmarrje të stafeve përkatës të UGJ dhe univeristeteve të huaja, si ekspertë apo konsulentë shkencorë të punimeve në nivel doktore, në fushat e njëjta të studimit dhe kërkimit .

c- Kufizimet që hasen:

1. Buxheti i kufizuar për lëvizshmëri jashtë vendit.
2. Mungesa e bazës materiale-laboratorike për të punuar së bashku me homologët e huaj në universitetin tonë.
3. Pamjaftueshmëria e buxhetit të universitetit për përmirësimin e infrastrukturës në mbështetje të kërkimit shkencor.
4. Sistemi i ndryshëm i organizimit të studimeve midis universiteteve, pasi jo të gjitha IAL ndjekin sistemin e Bolonjës (3+2). Kjo sjell vështirësi për stafin akademik dhe atë studentor (në njohjen e viteve të studimit dhe diplomave).

d- Matja e arritjeve:

1. Zgjerimi i kontakteve dhe bashkëpunimit me universitete apo qendra të kërkimit shkencor jashtë vendit;
2. Implementimi i marrëveshjeve kuadër ndërmjet UGJ dhe universiteteve apo qendrave të kërkimit shkencor jashtë vendit;
3. Numri i projekteve, apo botimeve të përbashkëta.
4. Shkalla e pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta ndërkombëtare.
5. Hapja e programeve të përbashkëta apo duale të studimit me universitetet e huaja;
6. Përfshirja e stafit akademik, studentor apo administrativë në programet e mobilitetit;
7. Përfitimet në infrastrukturën mësimore (pajisje laboratorike dhe kompjuterike) në kuadrin e projekteve Capacity –Building.

FINANCAT DHE BURIMET FINANCIARE

Në vendin tonë ka gati dy dekada që ka filluar procesi i transformimit të arsimit sipas modeleve të sotme më të përparuara. Zhvillimi dhe institucionalizimi i politikave arsimore, modelet bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies garantojnë edhe suksesin e këtij procesi. Jemi zbatues e po zbatohen programe mjaft ambicioze që synojnë transformimin rrënjësor (në strukturë e përmbajtje) të sistemit arsimor universitar. Këtij zhvillimi i përgjigjet madje dhe i paraprinë ristrukturimi dhe modernizimi i sistemit të Arsimit të Lartë.

Në Universitetin “Eqrem Çabej” mirëprehen idetë e reja bashkëkohore, programet e përparuara për zhvillimin e shoqërisë, ambicjet profesionale dhe angazhimet e mirëfillta pedagogjike e shkencore. Në Universitet takohen dhe mirëprehen kultura dhe rryma të ndryshme, gjithmonë duke respektuar individualitetet historike, të sotmen dhe të ardhmen e gjithësecilit.

Hartimi, menaxhimi dhe zbatimi i një Plani-Strategjik Zhvillimi të Universitetit është kyçi i zhvillimit të suksesshëm të universitetit tonë dhe do të ndihmojë për një integrim më të mirë të universitetit me shoqërinë dhe rajonin. Kjo është një detyrë që rrjedh nga ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë në Evropë dhe në botë, dhe në veçanti me procesin e Bolonjës. Për zhvillimin e metejshëm të universitetit nevojitet zbatimi me korektësi i

Strategjisë Kombëtare për Arsimin e Lartë për politikën afatmesme dhe afatgjatë në veprimtarinë e tij, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e stafit akademik dhe grupeve studentore të interesuara .

A. Objektivat:

1. Rritja e fondit grant i ardhur nga MASR-ja dhe përdorimi me efikasitet të lartë i tij.
2. Sigurimi i burimeve të tjera të ardhurave për të plotësuar buxhetin e UGJ-së nëpërmjet:
 - a. Rritjes së kontributit të studentëve për të përballuar koston e arsimit të lartë duke parashikuar diferencime në nivelet e tarifave të shkollimit mes programeve dhe cikleve të ndryshme si dhe mes formave të studimit .
 - b. Projekteve të ndryshme që do të paraqesin dhe zhvillojnë departamentet si dhe nga shërbimet që do të ofrojnë ata për të ndihmuar zhvillimin lokal, rajonal dhe me gjerë.
3. Shpërndarja e fondeve të bëhet deri në nivel njësie bazë.
4. Fondet e krijuara nga shërbimet në njësitë bazë të përdoren në mënyrë të pavarur nga to. Për këtë del e nevojshme që të krijohet kuadri i plotë ligjor dhe të vendosen një sërë shërbimesh të pagueshme, konform tarifave përkatëse të miratuara nga vetë Këshillat e departamenteve.
5. Të formulohen akte n/ligjore mbi % e shpërndarjes së të ardhurave të krijuara nga puna e specialisteve të vetë njësisive bazë në shërbimet ndaj komunitetit.

✓ **Veprimet që do të ndërmerren:**

1. Debate lidhur me plotësimin e legjislacionit për problemet financiare.
2. Rritja e efektivitetit dhe transparencës në përdorimin e fondeve.
3. Plan i detajuar dhe i shoqëruar me kostot që të demonstrojë se çfare shërbimesh synon të zhvillojë çdo departament.

✓ **Kufizimet që duhen përballuar:**

1. Sasia e vogël e fondeve në dispozicion.
2. Burimet e pakta të fondeve të thithura nga aktiviteti ndaj të tretëve apo edhe projekteve e shërbimeve të tjera.

✓ **Përballimi i këtyre kufizimeve:**

1. Miradministrimi i fondeve në dispozicion.
2. Planifikime me racionale të drejtshpërndarjes së fondeve në dispozicion.
3. Të vendosen tarifa shërbimesh për zera të rinj që sot për sot ende bëhen falas nga departamentet.

✓ **Matja e arritjeve:**

1. Me sasinë e fondeve të krijuara nga vetë njësia.
2. Me problematikat që janë zgjidhur nga mirëadministrimi i fondeve.
3. Me raportet e efektivitetit krahasuar midis njësive të ndryshme.

Ndryshimet ligjore në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e larë” kanë vënë theksin te Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë.

1. Institucionet e arsimit të lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare.
2. Institucioni i arsimit të lartë harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.
3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.
4. Përdorimi i fondeve publike nga Buxheti i Shtetit për institucionet e arsimit të lartë bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.

Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë.

1. Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:
 - a. Buxheti i Shtetit;
 - b. Pagesat e studentëve për arsimim;
 - c. Të ardhurat për shërbimet e kryera;
 - d. Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
 - e. Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;
 - f. Veprimtari kërkimore-shkencore;

2. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL-së, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë rregullojnë në aktet e tyre të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara dhe të ardhurave nga Buxheti i Shtetit.

Shpërndarja e fondeve nga Buxheti i Shtetit.

1. Fondet nga Buxheti i Shtetit shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:

- a. granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
 - b. granti i mësimdhënies;
 - c. granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.
2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
 3. Zbatimi i skemës së financimit, sipas këtij ligji, për institucionet publike të arsimit të lartë, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në suksesin. Një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të Burimeve Njerëzore do të jetë trajnimi i stafit kryesisht në Shqipëri, por edhe jashtë vendit, në Institucione të ngjashme.

Zhvillimi i aftësive të stafit në Univeristetin “Eqrem Çabej” është i rëndësishëm për të arritur performancë të lartë dhe sukses. Kapaciteti i drejtuesve dhe menaxherëve kombinohet me aftësitë menaxheriale të stafit në të gjithë hallkat e institucionit.

KERKESAT FINANCIARE TE STRATEGJISE

QEVERISJA BASHKËKOHORE

Autonomia, përgjegjshmëria dhe menaxhimi

1. Për t'iu përgjigjur sfidave të ndryshimeve të shpejta në shoqëri dhe ekonomi, IAL-të bashkëkohore kanë fituar **autonomi në zbatim të Ligjit 80/2015** neni 3,i cili shënoi një hap të rëndësishëm drejt rritjes së autonomisë së IAL-ve. Plani i Veprimit vendos detyra për hartimin e orientimeve kryesore për IAL-të se çfarë duhet të bëjnë ato për të qenë në përputhshmëri me këtë ligj. Çdo IAL do të përgatisë planin e saj strategjik 5-vjeçar, mbështetur në synimet dhe orientimet e kësaj Strategjie.
2. **Synimi afatgjatë është që çdo IAL duke qënë autonom të funksionojë si i tillë.** Autonomia për IAL-të do të mbështetet në katër kolona dhe konkretisht në:
 - a. **autonominë akademike** – bazuar në nenin 3 të ligjit 80/2015 që nënkupton liritë akademike dhe atë financiare të institucionit, që ky i fundit të mund të hartojë kurrikula novatore, përmbajtje të reja të lëndëve dhe, në kuadrin e Sigurimit të Cilësisë dhe kushtëzimeve financiare, të vendosë për hapjen apo mbylljen e programeve të studimeve dhe të formimeve. Kjo gjë do të ndikojë në përcaktimin e numrit të studentëve sipas fakulteteve për çdo IAL;
 - b. **autonominë strukturore** – që nënkupton se IAL-të përcaktojnë strukturat e tyre të brendshme (fakultete, departamente, etj.) dhe i përshtatin ato në përputhje me ndryshimet e rrethanave dhe të nevojave;
 - c. **autonominë administrative** – që nënkupton se IAL-të përcaktojnë mënyrat se si do të vetëmenaxhohen në përputhje me misionin e tyre – gjithsesi brenda kornizës së orientimeve kombëtare dhe në përputhje me praktikën e përparuar;
 - d. **autonominë financiare** – bazuar në nenin 3 të ligjit 80/2015 pika 3 gërma a ,që nënkupton se IAL-të do të kenë fleksibilitet të përcaktojnë krijimin dhe shpërndarjen e burimeve të brendshme mbi bazën e planeve dhe të buxhetit si edhe shpenzimin e tyre, brenda tavanit buxhetor. Kjo gjë ndikon në metodat e shpërndarjes së fondeve shtetërore për IAL-të.

Secili nga këto aspekte të autonomisë është i rëndësishëm për IAL-të e të ardhmes. Dy çështje kushtëzojnë një autonomi më të gjerë; **zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të menaxhimit dhe forcimi i përgjegjshmërisë dhe i transparencës**. Ato do të garantojnë autonomi të vërtetë.

3. Kushti i parë për IAL-të shtetërore që të fitojnë autonomi më të madhe, është që ato të kenë **menaxhim të brendshëm dhe vendimmarrje rigoroze e transparente, me llogaridhënie më të mirë**. Kjo gjë kërkon që IAL-të të kenë struktura të duhura dhe të praktikojnë procese të qarta menaxhimi.
4. **Koncepti modern** i menaxhimit është relativisht i ri për IAL-të (jo vetëm në Shqipëri) dhe ka të bëjë me:
 - a. përcaktimin e prioriteteve dhe realizimi i procesit të planifikimit dhe të hartimit të buxhetit mbi baza realiste dhe objektive;
 - b. respektimi i limiteve buxhetore të cilat janë të lidhura me politikat e ligji mbi buxhetin;
 - c. metodat e përcaktimit të përdorimit të burimeve të brendshme financiare përmes prioriteteve konkurruese;
 - d. monitorimin financiar dhe kontrollin në bazë IAL-je dhe fakulteti apo departamenti në varësi të njësisë buxhetore;
 - e. vendimet për nivelet e delegimit financiar;
 - f. mbështetjen e fuqishme profesionale për menaxhimin, si dhe kryesisht për aspektet financiare si dhe forcimin e rolit të Administratorit (në zbatim të kërkesave të ligjit për AL 80/2015;
 - g. zhvillimin e politikave për përmirësimin e mësimdhënies dhe të veprimtaritë e tjera akademike;
 - h. zbatimin dhe zhvillimin e procesit të Sigurimit të Cilësisë nga vetë IAL-të;
 - i. zhvillimin e kriterëve të punesimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të karrierës së tyre përzgjedhjen dhe rritjen në karrierë të personelit mbi bazën e kriterëve objektive;
 - j. menaxhimin treguesve të performancës së personelit si edhe përcaktimin e ngarkesës së punës;
 - k. strukturën e menaxhimit dhe përshkrimin e vendeve të punës të personave të përfshirë në aktivitetet manaxhues .

5. Ligji i AL 80/2015 kërkon prej IAL-ve të zhvillojnë secilin nga këto procese. **Plani i Veprimit parashikon që IAL-të të konceptojnë dhe të propozojnë procese qeverisëse dhe struktura për vendimmarrje.**
6. **Për të marrë vendime menaxhuese, çdo IAL ka nevojë për një grup të brendshëm menaxhimi, të kryesuar nga senati akademik , BA si dhe Administratori, dhe që përfshin edhe autoritete të larta drejtuese** (normalisht Zv/Rektorët dhe Dekanët); ligji i AL 80/2015 i referohet këtyre organeve . Ky është një grup *i brendshëm* menaxhimi, i cili nuk është i njëjtë me Këshillin e *jashtëm*, që do të nevojitet për llogaridhënien. Autoritetet e larta drejtuese duhet të ketë terma të qarta reference dhe duhet të operojë me një dokumentacion, i cili, nëse nuk ka arsye të ruajtjes së sekretit, duhet të jetë i disponueshëm për komunitetin e IAL-ve. Në zbatim të ligjit 80/2015 funksionet e Senatit Akademik janë përcaktuar në nenin 37 të tij si dhe në statutin e institucionit neni 14, kurse funksionet BA janë përcaktuar në nenin 49 të ligjit si dhe në statutin e institucionit neni 18 të tij.
7. **Për të përmbushur synimin afatgjatë, që çdo IAL të gëzojë autonomi** të plotë si institucion publik, plani i veprimit përcakton edhe hapat e mëtejshëm, krahas parakushteve për një qeverisje më efikase lidhur me menaxhimin e brendshëm dhe transparencën e jashtme. Pas përmbushjes së parakushteve, komponentët kryesorë të tyre do të përfshihen në Statutin e IAL-ve dhe ai do të fitojë statusin e IAL-së publike.
8. Kushti i dytë lidhet me **llogaridhënien e jashtme**. Në zbatim të Ligjit i AL 80/2015 neni 49 është ngritur Bordi i Administrativ” (BA) për çdo IAL, me një pjesëmarrje të caktuar anëtarësh të jashtëm. Ky është zhvillim pozitiv drejt një prirjeje të qartë ndërkombëtare, që IAL-të publike të kenë “Borde”, ku shumica e anëtarëve përfaqësojnë grupet e jashtme apo të brendshme të interesit. Anëtarët e brendshëm të BA-së zgjidhen nga personeli akademik, jo akademik dhe nga studentët, kurse anëtarët e jashtëm përcaktohen në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë .
9. **Me kohën, pasi BA-it të grumbullojnë përvojë dhe ial-të do të binden për vlerën e tyre**, ato të shndërrohen hap pas hapi në “Borde të Jashtme” (BJ), të përbërë nga një shumicë anëtarësh, që nuk janë të punësuar në strukturat e IAL-ve dhe si të tillë, ato (BJ) do të kenë përgjegjësinë përfundimtare për miratimin e planeve dhe buxhetit të IAL-ve, për kontrollin e përgjithshëm financiar dhe për emërimin e autoriteteve të IAL-ve. **Bordet e Jashtme** nuk do të merren me çështjet e përditshme të menaxhimit të IAL-së (ajo do të jetë detyra e Rektoratit,) dhe as me detyrat e Senatit për çështje akademike. **Transformimi i Bordeve të Administrimit në Borde të Jashtme** do të pasqyrohet edhe në ndryshimin ligjor të

institucioneve nga shtetërore në publike; ky ndryshim mund të mos ndodhë njëkohësisht në të gjitha IAL-të.

10. Anëtarët e jashtëm të BJ-së do të përzgjidhen nga personalitete jo vetëm të fushës ekonomike dhe nga bizneset lokale, por edhe nga shoqëria civile, nga të diplomuarit e IAL-ve përkatëse (ish studentë të cilët banojnë në qarkun ku zhvilloon veprimtarinë universiteti), nga institucione të sektorit publik, përfshirë edhe shkollat e mesme për ato IAL, që kanë si detyrë edhe formimin e mësuesve. Çdo anëtar i jashtëm do të përzgjidhet në bazë të kompetencës. Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Shqiptare (KRUSH) do t'i kërkohet të japë sugjerimet e veta për mënyrën e zgjedhjes dhe përbërjen e anëtarëve të jashtëm të BJ.

11. Llogaridhënia e jashtme, kërkon që IAL-të të publikojnë një raport vjetor, i cili do të përfshijë arritjet e institucionit, që lidhen me tregues të specifikuar të performancës dhe me rezultatet e përfuara nga procesi i jashtëm i Sigurimit të Cilësisë. Raporti do të përfshijë edhe bilancin vjetor të IAL-ve, të monitoruar dhe kontrolluar në mënyrë të pavarur. Plani i Veprimit do të bëjë propozime për mënyrën e monitorimit si edhe për treguesit financiarë dhe të performancës të IAL-ve. Ky monitorim, së bashku me kontrollin e jashtëm të pavarur do të përbëjë një garanci ndaj keqpërdorimit të fondeve. në kuadrin e llogaridhënies dhe të transparencës në universitete operohet duke hedhur të dhënat mujore ne portalin për transparencën e buxhetit të universiteteve që ka mision transparencën për buxhetin e alokuar, shpenzimet dhe investimet realizuara dhe të planifikuara nëpër universitete.

12. Së fundi, lidhur me llogaridhënien, do të zbatohen tre nivele të pavarur kontrolli institucional të IAL-ve nga:

- a. Kontrolli i Lartë i Shtetit
- b. Kontrolli i Brendshëm i Këshillit të Ministrave,
- c. Drejtoria e Kontrollit të MASH-it

Kjo gjë mund të jetë kohë-shpenzuese, pasi ka mbivendosi të kontrolleve. Plani i Veprimit do të përfshijë një vlerësim, për të parë se si mund të ulet barra e kontrollit

13. Autonomia e plotë për IAL-të Ndryshimet në kulturën e menaxhimit janë të konsiderueshme por autonomia e plote mund të arrihet vetëm pasi të ketë siguruar autonomi financiare .

MBI SITUACIONIN NË UGJ

ANET E FORTA TE UGJ

1. Pervoja ne punen mesimore e shkencore e grumbulluar ne keto 50 vjete.
2. Kualifikimi i kenaqshem shkencor e pedagogjik i stafit tone akademik.
3. Ekzistenca e nje baze materiale e laboratorike baze per pune mesimore e kerkimore.
4. Ekzistenca e nje biblioteke tashme me nje pervoje te konsiderueshme.
5. Arritjet e deritashme nga stafi akademik si ne fushen akademike dhe ne ate shkencore.(studime,botime,projekte,etj.,etj..)
6. Ekzistenca e nje sere lidhjesh dhe raportesh pune me homologet tane brenda dhe jashte vendit.

Këto gjykime mbështeten:

- a. Në punën kualifikuese qe vazhdon me ritme te larta.
- b. Në përmirësimet e vazhdueshme të mbështetjes financiare.
- c. Në prezencën tashme te fondeve te veçanta ne funksion te kerkimit.
- d. Ne ate ç'ka kemi arritur deri me tashme.

ANËT E DOBËTA TË UGJ

1. Mungesa e kontigjentit cilesor ne pranimet e reja te trupes studentore.
2. Mospreferenca e te diplomuareve jashte vendit per te punuar ne universitetet rajonale.
3. Mungesa e nje baze materiale – laboratorike ne nivelet e kerkuara nga koha.
4. Tradita shume e re krahasuar me homologet ne bote.
5. Mungesa e mjeteve te duhura financiare per mbështetjen e punes kerkimore –shkencore ne nivele bashkekohore.
6. Buxheti nuk administrohet duke u dispeçeruar deri ne njesite baze (Departamentet) ku paraqiten nevojat konkrete.
7. Rrudhja e poullsisë në rajonin jugor si pasojë e emigracionit dhe largimit të të rinjëve drejt qendrave të mëdha urbane.

Këto gjykime mbesheten:

- a. Në krahasimin e gjendjes tonë me sihomologet tanë në botë.
- b. Ne mungesat dhe problematikat që na krijohen në punën tonë të përditshme.
- c. Në përvojen tonë disavjeçare të djeshme dhe të sotme.
- d. Në rezultatet e arritura në punën tonë sot dhe në të kaluarën.

**KUSHTET PER OPORTUNITETE TE UGJ TANI DHE NE TE ARDHMEN
(Lokale, Rajonale, Kombëtare e Ndërkombëtare)**

1. Ekzistenca e vet universitetit tone ne nje nga trevat me arsimdashese te Republikes.
2. Karakteristikat e zones dhe rajonit ku ushtrohet aktiviteti universitar.
3. Ekzistenca e resurseve njerezore e materiale te afte per nje pune te kualifikuar.
4. Stafet e kualifikuara qe mund dhe jane te gatshme per oportunitetet e nevojshme ne sherbim te komunitetit dhe sipermarrjes private.
5. Nevojat shumeplaneshe te ekonomise rajonale per fjalen e kualifikuar.
6. Interesat shumeplaneshe te zones dhe universitetit tonë.

**KËRCËNIMET E JASHTME ME TË CILAT PËRBALLET UGJ-ja DHE
BARRIERAT QË DUHEN KAPERCYER**

1. Mungesa e specialiteteve per zona te ngushta te kerkimit.
2. Mosperputhjet strukture dhe teknike qe nuk te japin mundesine e gjetjes se homologeve ne Evrope e me gjere.
3. Prapambetja e trasheguar nga e kaluara.
4. Problematikat qe kalon ne pergjithesi aktualisht shoqeria jone.
5. Konkurenca e pabarabarte me homologet e tij.
6. Hapja e Universiteteve dhe programeve te reja te studimit mbi bazen e gjykimeve jo profesionale dhe jashte kritereve e parametrave te kerkuara duke ndikuar drejt se drejti edhe ne uljen e cilesise se pranimeve ne institucionet e Arsimit te Larte.
7. Moskuptimet e drejta e mos zbatimet reale te autonomise se organizimit, financimit e drejtimit ne universitete, etj.